



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.193/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu ,në lëndën penale kundër të pandehurit B.B sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr .2403/15 të dt.01.3.2016, për shkak të veprës penale: vjedhje nga neni 325 par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit B.B dhe të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari me dt.04.10.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B. B i lindur me dt.02.9.1980 në fsh. G. Komuna e Klinës , tani me vendbanim në fsh. Z.Komuna e Klinës, i biri i M dhe nënës S e gjinisë Z, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 15.8.2015, rreth orës 02:00 , pas mesnate, në Spitalin regional në Pejë, me qëllim që vetes ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme , merr pasurin e luajtshme të të dëmtuarës B.K nga Peja , në atë mënyrë që e dëmtuara pasi që kishte shkuar në vendin e cekur më lartë për ta dërguar fëmijën e motrës dhe gjatë qëndrimit të saj prej dy orësh, aty i pandehuri e shfrytëzon rastin dhe merr telefonin e të dëmtuarës të tipit samsung galaxy 3, në vlerë prej 180 euro, dhe pas identifikimit nga zyra ligjore e IPKO-s telefoni i është gjetur në posedim të pandehurit ,

-me çka ka kryer vepra penale : të vjedhjes nga neni 325 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 325 par 1 të KPRK-së.

E G J Y K O N :

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1(një)viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Dhe :

Me dënim të kushtëzuar burgu,

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro -15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.01.3.2016 kundër të pandehurit B.B ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2403/15, për vepër penale : të vjedhjes nga neni 325 par 1 të KPRK-së të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoi fajësinë gjyqtari kaloi në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme i pandehuri është mbajtës i familjes prej 7 anëtarësh, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.04.10.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet

Ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë

E përmes kësaj Gjykate .